



PROVISIONAL INSTITUTIONS OF SELF GOVERNMENT

**KUVENDI I KOSOVËS
СКУПШТИНА КОСОВА
ASSEMBLY OF KOSOVO**

**Komisioni për Ekonomi, Tregti, Industri,
Energjetikë, Transport dhe Telekomunikacion**

Mbledhja e dt. 11.09. 2007
Salla: C-301 ora 10.00
Ndërtesa e Kuvendit të Kosovës.

Procesverbal

Morën pjesë: Ibush Jonuzi - kryetar, Bajrush Xhemaili, Mahir Yagcillar, Hatixhe Hoxha, Ilmi Ahmeti, Zef Morina Sale Berisha, Milazim Haliti, Brikena Kryeziu, Fadil Gashi, Xhevdet Neziraj, Vezira Emrush, ndërsa munguan: Sllagjan Iliq dhe Ylber Hysaj,

Të pranishëm ishin përfaqësuesit e : Zyrës së kryeministrit, zëvendësministri i MTPT-së, Kuvendit komunal të Fushë Kosovës dhe i Drejtoratit për Urbanizëm dhe Planifikim në Prishtinë.

Mbledhjen e drejtoi Ibush Jonuzi – kryetar i komisionit, me këtë

Rend dite

1. Miratimi i procesverbaleve të mbledhjeve të më parshme
2. Shqyrtimi i projektit –vendimit të Qeverisë për shpalljen e hapësirës-trasesë, nëpër të cilën do të ndërtohet autostrada Morinë-Merdar, zonë me interes të veçantë në Kosovë” .
3. Të ndryshme.

Miratohet rendi i propozuar i ditës;
Procesverbali i mbledhjes së më parshme u shty.

Ibush Jonuzi- kërkoi nga përfaqësuesit e MTPT-ja, të japin shpjegime konkrete .
lidhur me propozim-projektin e vendimit për shpalljen e hapësirës-trasesë, nëpër të cilën do të ndërtohet autostrada Morinë-Merdar, zonë me interes të veçantë për Kosovën”

Blerim Baruti- zv. ministër i MTPT-së

Projekti është realizuar nga Ministria e MTPT-së. Janë bërë të gjitha analizat e mundshme duke filluar nga studimi i fizibilitetit, evidencimi i pronave, parallogaritja për kompensimin e pronave, duke përfshirë edhe procedurat dhe çështjet e tjera teknike që kanë të bëjnë në tërësi me realizimin e projektit të autostradës.

Florim Grajqevci- diskutimin e vet e përqendroi në vështirësitë e mundshme që do të paraqiten gjatë zbatimit të fazës së shpronësimit-kompensimit të pronës në përgjithësi. Sipas tij problem në vete paraqitet se cili ligj zbatohet për shpronësim. Nëse duhet pritur hyrjen në fuqi të Ligjit për shpronësim që është në procedurën e shpalljes nga PSSP-ja (e që sipas informatave nuk do të shpallet para se të procedohet sërish nga Kuvendi) fillimi i realizimit të shpronësimit do të shtyhet. Shtyrja, gjithashtu, do të bëhet edhe nga fakti se Ligji për shpronësim nuk lejon fillimin e realizimit të projekteve para se të zgjidhen çështjet pronëso- juridike dhe të kompensohen pronat. Sipas tij gjatë hartimit të projektvendimit për shpalljen e zonës me interes të veçantë Ministria ka bashkëpunuar me strukturat përkatëse të të gjitha komunave. Sipas tij duhet gjetur zgjidhje me AKM-ën –Shtyllën e IV-të që prona shoqërore bujqësore të ndahet pa kompensim.

Lulëzim Nixha- diskutimin e përqendroi më tepër në projektin e autostradës pa e mohuar rëndësinë nacionale të projektit por duke kritikuar Ministrinë për mos bashkëpunim me Komunën dhe me Drejtorinë e Urbanizmit dhe Planifikimit të Prishtinës. Kontrata për Projektim të autostradës është nënshkruar gjatë mandatit të ish ministrit Morina që ka pasur bashkëpunim të ngushtë me kuvendin komunal të Prishtinës .Ish projekti tani është zhvendosur nga zona e Obiliqit në zonën urbane të Prishtinës pa konsultime dhe në kundërshtim me Planin strategjik rregullator të Prishtinës . Deri para pak kohe ky projekt ishte edhe sekret për komunën dhe opinionin. Planin strategjik komuna e ka miratuar në vitin 2004 ku i kemi përfshirë të gjitha zhvillimet e ardhshme urbane të trafikut. Rezultatet e hulumtimit që janë bërë për të dy projektet (zhvendosja) janë në kundërshtim me interesat e përgjithshme të urbanizmit të Prishtinës. Duhet të bëhen korrigjime, sepse unaza e tretë gërshetohet me trasenë e kësaj autoudhe, që është pengesë funksionale reciproke. Arsyeja e zhvendosjes së trasesë ka qenë gjoja planifikimi i një mihjeje të re të thëngjillit e që është arsyetim i pa qëndrueshëm. Tani pas vendimit se nuk do të ketë mihje dhe mos kthimi i trasesë sipas ish projektit, dëshmon se mihja nuk ka qenë arsyeja e zhvendosjes së trasesë por mbetën interesat tjera subjektive. Ne jemi për projektin me kusht që plani strategjik rregullativ i Prishtinës të mos cenohet dhe para se të filloi realizimi, projekti duhet të organizohen prezantime dhe diskutime publike, përfundoi Nixha.

Kaqusha Jashari- vlerësoi se projekti është njeri nga projektet me kapitale të Kosovës andaj në këtë projekt duhet mundësuar qasje që të gjitha institucioneve dhe të opinionit kosovar. Projekti është, dhe ka mbetur “pronë” vetëm e Ministrisë. Projekti është hartuar dhe ruajtur pa transparencë . Ajo propozoi që për vlerësimin dhe realizimin e projektit të ketë qasje edhe Kuvendi i Kosovës. Ajo propozoi që institucionet përgjegjëse të formojnë komisione ekspertësh për vlerësim dhe realizim të projektit, përfundoi Jashari.

Përfaqësuesi nga KK. i Fushë Kosovës paralajmëroi se për momentin mungon legjislacioni përkatës për shpronësim. Realizimi i fazës së shpronësimit mund të zgjasi tej

mase nga fakti se ligji i ri për shpronësim (nëse shpallet) parasheh së pari të kompensohet prona e pastaj të shfrytëzohet për realizimin e projekteve.

Zef Morina Projekti ka dy aspekte: atë politik dhe atë ekonomik. Në aspektin politik projekti është nismë e vitit 1993 (në kohën e Rugovës) nismë për të cilën nuk duhet të pretendojë askush të përvetësojë merita të veçanta. Ai tha se në kohën kur ishte ministër, bashkëpunimi me komuna lidhur me këtë projekt ishte në nivel të mirë dhe shprehu keqardhje tani për shkallën e ulët të transparencës dhe të bashkëpunimit të Ministrisë me komuna e në veçanti me Prishtinën. Në vazhdim ai u pajtua me parafolësit që t'i propozohet Kuvendit që të rekomandojë formimin e komisioneve të pavarura prej ekspertëve për kontrollime e përcjellje të realizimit të projektit.

Bashkëpunimi i Ministrisë duhet të shtohet në shkallën e duhur me të gjitha komunat nëpër të cilat kalon autostrada. Duhet të organizohen takime me qytetarë për sensibilizimin e tyre lidhur me rëndësinë e autostradës, me qëllim të mbështetjes sa më të madhe. Komunat janë më kompetente për ndarjen e mendimit- lejes për shtrirjen e trasesë nëpër territorin e tyre, andaj ato është dashur dhe duhet gjithsesi, konsultuar përfundoi Morina.

Mahir Yagcillar foli për rëndësinë e autostradës duke aluduar që kur të diskutohet për autostradën të diskutohet në kuadër të sistemit të përgjithshëm rrugor. Ai propozoi të organizohet edhe një dëgjim publik më i gjerë dhe të ftohen sa më shumë ekspertë të fushës përkatëse. Ne duhet të fillojmë të iniciojmë edhe nisma të tjera për komunikacionin siq janë hekurudhat, trenat e shpejtë e tjera, përfundoi Yagcillar.

Bajrush Xhemali shprehi pakënaqësi për shkallën e ulët të bashkëpunimit dhe të transparencës së Ministrisë me dhe ndaj subjekteve përkatëse lidhur me projektin. Ne si komision me punën dhe me angazhimin e gjerëtanishëm kemi ngritur transparencën dhe sensibilizimin e opinionit. Zhvendosja e projektit dhe jotransparenca kanë krijuar hapësirë për dilema e spekulime të tjera. Ai në rrugën e realizimit të projektit si të autostradës ashtu edhe të kompensimit të pronave paralajmrojë shumë detyra dhe vështirësi. Shpronësimin e parashikoi të pasuksesshëm për shkak të mosshpalljes së ligjit për shpronësim nga PSSP-ja , përfundoi Xhemali.

Brikenda Kryeziu u përqendrua në rëndësinë e transparencës dhe të organizimit të diskutimit publik të projektit, të kyçjes sa më të madhe të ekspertëve të pavarur. Me këto organizime krijohen parakushte për një projekt të qëndrueshëm. Parashtrroi pyetjen se Ministria ka organizuar dhe planifikon të organizojë konferenca për shtyp për mbështetje nga donatorët e jashtëm dhe thithjen e investimeve të huaja për këtë projekt.

Sala Berisha Shala u pajtua me parafolësit dhe u fokusua në studimet e fizibilitetit për fushat përkatëse veç e veç brenda projektit, zhvendosjes së trasesë, organizimit të debatit publik, mos bashkëpunimit të ministrisë me komuna e tjera.

Pra projekti duhet të ndihmohet me krijimin e disa parakushteve. Sipas saj edhe shpronësimi është dashur të përfshihej brenda studimit të fizibilitetit. Sa dhe si është përshtatur projekti nga aspekti i sizmologjisë. Sugjeroi se shpronësimi duhet trajtuar vetëm me ligj. Parashtrroi pyetje për shkallën e bashkëpunimit të Ministrisë për TPT-ën me MEM-in, MMPH-së dhe komunat në përgjithësi, për projektet alternative, për

dallimin e çmimit sipas projektit të parë me të zhvendosurin, pyetje me të cilat duhet njoftuar opinionin, përfundoi Berisha.

Hilmi Ahmeti apeloj që diskutimet të fokusohen vetëm në rendin e ditës sepse të tjerat janë diskutuar më parë. Ai tha se duhet të deklarohej vetëm për projektvendimin e Qeverisë për shpalljen e hapësirës nëpër të cilën kalon autostrada zonë me interes të veçantë. Ai shprehu besimin se Ministria ka bashkëpunuar me komunat nëpër të cilat zona kalon autostrada dhe ato tani nuk lejojnë ndërtime në ato zona. Transparenca e kufizuar ka edhe arsyen e vet sepse në të kundërtën do të shtohet shkalla e invazionit të ndërtimeve pa leje përreth zonave. Në fund ai propozoi ajo të bashkëpunohet me AKM-ën me qëllim që prona publike të mos privatizohet, por ajo të dedikohet për shtrirje të trasesë së autostradës që do të zbritet shkalla e shumës së përgjithshme të kompensimit, të shtohet bashkëpunimi i Ministrisë me komuna gjatë fazës së shpronësimit dhe kompensimit të pronave. Ai konkludoi se sa më shumë të vonohet shpronësimi kostoja e ndërtimit të autostradës do të jetë më e lartë.

Hatixhe Hoxha, si edhe parafolësit, u përqendrua në ngritjen e shkallës së transparencës, bashkëpunimit të Ministrisë së TPT-ës, MEM-it, MMPH me komunat, të formimit të komisioneve përkatëse të pavarura për mbikëqyrje të zbatimit të projekteve.

Milazim Haliti sipas tij tani për fazën e shpronësimit dhe të kompensimit është me rëndësi që Ligji për shpronësime të shpallet sa më parë. Komisioni tani do duhet të preokupohej me hulumtimin e burimeve financiare që nga buxheti i vitit 2008 të ndahen 20 milion euro për shpronësim. Për mos shpalljen publike të projektit, qëllim i Ministrisë ka qenë që mos të bëhet invazion shitblerjeje drejtë zonës së trasesë. Ndryshimi i trasesë duhet të vlerësohet nga ekspertët përfundoi Haliti.

Xhevdet Neziraj mendon se prioritet i komisionit është të bëhet presion që Ligji për shpronësim të shpallet sa më parë. Pa këtë ligj shpronësimi nuk mund të bëhet. Lidhur me transparencën tha se institucionet duhet të jenë më aktive dhe të sensibilizojnë opinionin lidhur me interesin e përgjithshëm ashtu që transparenca vërtet të jetë në funksion të interesit të përgjithshëm.

Ibush Jonuzi duke falënderuar të gjithë pjesëmarrësit për kontributin e dhënë propozoi rekomandimet në vijim të cilat komisioni njëzëri i miratoi: **Rekomandimet.**

- U rekomandohet Qeverisë së Kosovës, MTT-së, MMPH-së dhe komunave (organeve qendrore dhe lokale) përkatëse që të riaktivizojnë dhe të shtojnë bashkëpunimin e ndërsjellë dhe harmonizimin e qëndrimeve vlerësuese në suaza të kompetencave si për projektin e autostradës ashtu edhe për hapësirën që do të shfrytëzohet për ndërtimin e autostradës Morinë-Merdar, zonë me interes të veçantë.

I rekomandohet Qeverisë së Kosovës ta emërojë një komision të pavarur profesional, prej dy ekipeve ekspertësh, njëri për vlerësimin e projektit të autostradës me theks të

veçantë për territorin e Prishtinës dhe tjetri për vlerësimin e ligjshmërisë së procedurave të shpronësimit të pronave,

I rekomandohet Qeverisë së Kosovës ta emërojë një komision ekspertësh prej dy ekipeve për përcjelljen e realizimit të projektit, njëri për autostradë dhe tjetri për shpronësim.

I rekomandohet Kryesisë së Kuvendit të Kosovës të aktualizojë mundësinë e ushtrimit të kërkesës ndaj PSSP-së për përshpejtimin e ndërmarrjes së masave për shpalljen e Ligjit për shpronësim, i miratuar në Kuvendin e Kosovës.

Të ndryshme:

-Kryetari Jonuzi i njoftoi të pranishmit për takimet që kanë pasur së bashku me Bajrush Xhemailin në kërkesë të përfaqësuesve përkatës të UNMIK-ut, të AKM-së, dhe të Zyres amerikane në Prishtinë. Takimet janë mbajtur dhe është debatuar për rezolutën e komisionit për ETIETT për Kuvendin e Kosovës që ka të bëjë me shpalljen e NSH “Trepça” N. Publike me interes nacional. Nga këto takime ende nuk është gjetur ndonjë zgjidhje definitive për statusin e “Trepçës” edhe pse ka paralajmërim se çështja mund të mbetet në kompetencë të institucioneve kosovare, por pas zgjidhjes së statusit politik të Kosovës.

Ka paralajmërim dhe pajtueshmëri që paraprakisht të behet ndryshimi i Rregullores së UNMIK-ut 2005/48.

-Mbledhja e radhës mbahet me 18.09.2005

Kryetar i Komisionit

Ibush Jonuzi